



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 2276/Prot.  
13

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM

NR. 63, DATË 29.05.2024

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMIT TË QIRASË”.**

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL “ përkatësisht :Neni 3, pika 3 ; Neni 13,14,15,16, dhe Neni 33,34,35 “SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për sistemin e pikezimit mbi projektin “SUBVENCIONIMIT TË QIRASË”.

NR.	SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT “SUBVENCIONI I QIRASË”	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	25
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	6
ii	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.	5
iii	Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.	5
iv	Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4
v	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike.	5
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë,ku përfshihen edhe vajzat nëna.	6
ii	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t’u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore.	5
iii	Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë.	6
iv	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	4
v	Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	4
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie.	4



ii	Individë më statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.	2
iii	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.	2
iv	Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese.	2
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	2
vi, vii,viii	Punonjës i reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH. Punonjësit e repartit RENEA. Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.	2
ix	Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit.	2
x	Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian.	4
xi	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit.	2
xii	Vajzat Nëna.	2
xiii	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.	1
<b>D</b>	<b>KUSHTET EKONOMIKE</b>	<b>25</b>
i	Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	15
ii	Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	10
iii	Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	0
	<b>TOTALI PIKË</b>	<b>100</b>

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 23 vota

2. Vota Pro 23

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 30.05.2024